



Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 12 maj 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Kërkesën e Thaçit për Zgjatje të Afatit

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësit të Hashim Thaçit
Dejvid Huper

Mbrojtësit të Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtësit të Rexhep Selimit
Dejvid Jang

Mbrojtëses së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në pajtim me nenet 39(1) dhe (13) dhe 41(10) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”), dhe rregullat 9(5)(a) dhe (6) dhe 57(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon urdhrin e mëposhtëm.

I. HISTORIKU PROCEDURAL DHE PARASHTRIMET

1. Më 24 shkurt 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ndryshoi afatin për dorëzimin e parashtrimeve lidhur me nëse ekzistojnë ende arsyet për vazhdimin e paraburgimit, deri në dhjetë ditë pas njoftimit të vendimit të Panelit të Gjykatës së Apelit mbi apelin e Hashim Thaçit (“z. Thaçi”) kundër vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake për refuzimin e lirim të përkohshëm.²

2. Më 30 prill 2021, Paneli i Gjykatës së Apelit rrëzoi apelin e z. Thaçi kundër vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake për refuzimin e lirim të përkohshëm.³

3. Më 7 maj 2021, z. Thaçi parashtrroi kërkesë për ndryshimin e afatit, për të mundësuar dorëzimin deri të hënën, 31 maj 2021, të parashtrimeve lidhur me nëse ekzistojnë ende arsyet për vazhdimin e paraburgimit, në mënyrë që të mund të sigurohej informacion i mëtejshëm (“Kërkesa”).⁴

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

4. Sipas rregullës 9(5)(a) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mund të shkurtojë *proprio motu* afatet e përcaktuara prej Rregullores apo prej Panelit.

¹ KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

² KSC-BC-2020-06, F00206, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Përbashkët të Mbrojtjes për Zgjatjen e Afatit*, 24 shkurt 2021, publik, para. 6.

³ KSC-BC-2020-06/IA004, F00005/RED, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit lidhur me Lirimin e Përkohshëm*, 30 prill 2021, publik, para. 91.

⁴ KSC-BC-2020-06, F00284, Mbrojtja e z. Thaçi, *Kërkesë për Zgjatjen e Afatit për Dorëzimin e Parashtrimeve në lidhje me Vazhdimin e Paraburgimit të z. Thaçi (“Kërkesa”)*, 7 maj 2021, konfidenciale, para. 3, 6.

5. Sipas rregullës Rule 9(6) të Rregullores, kur nuk i shkaktohet padrejtësi palës kundërshtare, vendimi në lidhje me një mocion për ndryshimin e afateve mund të merret edhe pa i dhënë palës kundërshtare mundësinë për të shprehur mendimin.

6. Neni 41(10) i Ligjit dhe rregulla 57(2) e Rregullores përcaktojnë se, pasi të kenë kaluar dy (2) muaj nga vendimi i fundit në lidhje me paraburgimin, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ose Paneli i ngarkuar me çështjen vlerëson nëse ekzistojnë ende arsyet për mbajtjen në paraburgim dhe jep një vendim për vazhdimin ose përfundimin e paraburgimit.

III. DISKUTIM

7. Pasi shqyrtoi arsyet e paraqitura nga z. Thaçi, në veçanti se ai është në fazë të marrjes së informacionit shtesë në mbështetje të parashtrimeve të tij, të cilin nuk mund ta siguronte më parë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se janë dhënë arsye të vlefshme të cilat përlligjin zgjatjen e kërkuar të afatit. Në këtë kontekst, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se z. Thaçi ka hequr dorë nga e drejta për rishikimin e paraburgimit të tij para përfundimit të afatit dymujor të përcaktuar në nenin 41(10) të Ligjit dhe në rregullën 57(2) të Rregullores.⁵

IV. VENDIM

8. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a. **MIRATON** Kërkesën; dhe
- b. **URDHËRON** z. Thaçi të dorëzojë parashtrime lidhur me nëse ekzistojnë ende arsyet për vazhdimin e paraburgimit të tij, deri të

⁵ KSC-BC-2020-06, F00205, Mbrojtja, Kërkesë e Përbashkët e Mbrojtjes për Zgjatjen e Afatit, 23 shkurt 2021, publike, para. 5; Kërkesa, para. 4.

